

Në bazë të nenit 19, pika (m) të Statutit të Komunës së Suharekës dhe nenit 3.2, pika(b), (c) të rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr.2000/45, Kuvendi i Komunës së Suharekës në seancën e mbajtur më 28.12.2005 nxjerrë:

Rregullore

Për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive „13 Qershori” në Suharekë

Neni 1.

1.1 Me këtë rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve në Suharekë për aktivitetet sportive të klubeve të licencuara në federatat gjegjëse si dhe klubeve private , për manifestime të ndryshme kulturore, tubime partiake, revista ose rekreacion.

Neni 2.

2.1 Klubet dhe subjektet tjera të interesuara për shfrytëzimin e palestrës së sporteve duhet që së paku tri ditë para mbajtjes së manifestimit , tubimit apo ndeshjes t’i drejtojnë një kërkesë me shkrim menaxherit të palestrës sportive, i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve .

2.2. Klubet sportive të komunës së Suharekës të cilat janë të licencuara në federatat gjegjëse dhe që kanë kalendarin e rregullt të garimeve nuk i nënshtrohen paragrafit 2.1.

Neni 3.

3.1 Të gjitha klubet që zhvillojnë veprimtarit e tyre në palestrën e sporteve e që janë të licencuara në federatat gjegjëse, apo garojnë në kuadër të federatave përkatëse e që janë nga komuna e Suharekës, mundë ta shfrytëzojnë pallatin e sporteve për stërvitje dhe garim në kuadër të sistemit të tyre të garimit, sipas këtyre pagesave:

Për stërvitje sportive -----10 €pa ndriçim, 15 €me ndriçim, (për një orë)

Për stërvitje të klubeve private-----20 €pa ndriçim, 25 €me ndriçim (për një orë)

Për zhvillimin e ndeshjes pa bileta----50 €(për një orë)

Për zhvillimin e ndeshjes me bileta----30% nga mjetet e inkasuar të biletave.

3.2. Palestra e sporteve mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme sipas këtij kompensimi :

1. për ngjarje komerciale

(panaire, revy, ekspozita, dhe të ngjashme) ---- 200 €(për një orë)

2. për ngjarje humanitare – gratis

3. Për koncerte 30% nga inkasimi i mjeteve prej biletave.

Neni 4.

4.1 Të gjitha klubet sportive jashtë komunës së Therandës, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të detyruara të shfrytëzojnë palestrën sportive në Therandë duhet të paguajnë 100 €për një orë.

Neni 5.

5.1 Përveç klubeve të rregullta, palestrën e sporteve mund ta shfrytëzojnë edhe klubet, shoqatat si dhe organizatat punuese për qëllime rekreative por janë të obliguara të paguajnë për një orë:

Pa ndriçim -----20 € për 1 orë

Me ndriçim -----25 € për 1 orë

Me ngrohje -----paguhen shpenzimet e ngrohjes

5.2. Për fushata të grupeve politike , subjekteve dhe koalicioneve , shfrytëzimi i sallës sportive për një orë kushton 150 €

Neni 6.

6.1. Palestra e sporteve mund t’iu lejohet për shfrytëzim edhe organizatave të ndryshme për koncerte apo shfaqje të ndryshme, duke paguar kompensimin prej 30% të mjeteve të inkasuar.

6.2. Prej këtyre obligimeve lirohen organizimet shtetërore apo manifestimet me karakter kombëtar, në qoftë se organizatori nuk inkason të hyra nga shitja e biletave.

6.3. Nga obligimet komunale lirohen 50% edhe klubet e femrave që garojnë në ligat e para të Kosovës, me qëllim të nxitjes dhe avancimit të tyre ne marrjen me veprimtari sportive.

6.4. Lirohen 50% shoqatat e personave me aftësi të kufizuara.

6.5. KFOR-I, SHPK, TMK, SHIL, HANDIKOS dhe shoqata e shurdhmemecëve sipas kërkesave lirohen me marrëveshje të veçantë 2 orë gratis në muaj.

Neni 7.

7.1. Kompanitë televizive mund t’i transmetojnë ngjarjet nga pallati i sporteve sipas marrëveshjeve paraprake me organizatorin.

Neni 8.

8.1 Subjekteve të interesuara i u mundësohet vendosja e reklamave të tyre sipas këtyre tarifave:

Vendosja e reklamave: me dimensione: për 1 muaj:

1. Në qendrën e fushës së basketbollit, në parket 200 €

2. Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit .. 100 €

3. Në hapësirën e 6-metërshit të fushës së hendbollit..... 2 x 0.60m100 €

4. Në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit .. 2 x 0.60m.....100 €

5. Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit..... 3 x 0.60m100 €

6. Në pjesën verore (A dhe B) të palestrës....50 €/ m²

7. Në pjesën jugore (C dhe D) të palestrës ...50 €/ m²

8. Në pjesën lindore dhe perëndimore të palestrës..... 25 €/ m²

8.2 Kohëzgjatja e vendosjes së reklamës në vendin e zgjedhur do të jetë për një vit, me të drejtë vazhdimi përmes kontratës së re.

8.3 Vendi vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të kontratës.

8.4 Shpenzimet e shkrimit dhe vendosjes së reklamës i bartë subjekti i interesuar.

8.5 Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo tre muaj, dhe atë në fillim të periudhës tremujore.

8.6 Në palestrën e sporteve, klubet mund të ekspozojnë reklamën lëvizëse të sponsorëve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamën ekzistuese në palestër.

8.7 Klubet e interesuara për vendosjen e reklamave në qendër të fushës (në parket) duhet të paguajnë çmimin sipas tarifave nga neni 8 pika 1.

8.8 Në rastet ku paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njëjtin vend, përzgjidhja do të bëhet me licitacion.

Neni 9.

9.1 Në palestrën e sporteve nuk lejohet mbajtja e armëve, mjeteve eksplozive, pirja e duhanit dhe alkoolit. Personat të cilët mund të hasen këto mjete, do të largohen nga palestra e sporteve, me përjashtim të formacioneve të rregullta të caktuara për mbajtjen e rendit.

Neni 10.

10.1 Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse, përgjegjësia bie të shfrytëzuesit gjatë asaj kohe, andaj kompensimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhirollogarinë e palestrës sportive të K.K- së.

10.2. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad - hoc prej tre anëtarëve i emëruar nga drejtoria për kulturë dhe sport dhe evidenton dëmet e shkaktuara. Në rast të mos kompensimit të dëmeve në afatin e paraparë kohor , procedura e kompensimit do të vendoset përmes organeve gjyqësore , përfshirë kamatën ligjore (si dhe ndalesën për shfrytëzuesin deri në zgjedhjen e kontestit).

Neni 11.

11.1. Për shfrytëzimin e palestrës së sportit bëhet kontrata me shkrim ndërmjet drejtorisë së Kulturës, rinisë dhe sporteve, si dhënësi i objektit në shfrytëzim në njërin anë dhe përfaqësuesit të klubit apo subjektit tjetër përkatës në anën tjetër, si shfrytëzues.

Neni 12.

12.1. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së të njëjtës.

Neni 13.

14.1. Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas aprovimit nga Kuvendi Komunal i Suharekës.

KUVENDI I KOMUNËS - SUHAREKË

01.nr. _____
Suharekë, datë _____

Kryetari i Kuvendit

Sali Asllanaj

